



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 xxxx xxx

Nr. 291 Prot.

Tiranë, më 25 shkurt 2010

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

URDHËR

Nr.120, datë 25.02.2010

PËR

**ORGANIZIMIN E KONSULTIMEVE NË SHËRBIM TË NXËNËSVE TË KLASËS
IX NË ARSIMIN BAZË**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 53 të Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995, i ndryshuar "Për sistemin arsimor parauniversitar"

URDHËROJ:

Organizimin e konsultimeve në shërbim të nxënësve të klasës IX në arsimin e bazë, si më poshtë:

1. Drejtoria e shkollës afishon në këndin "Provimet e Lirimit" grafikun e konsultimeve për secilën nga lëndët e provimeve së bashku me emrin e mësuesit që i zhvillon.
2. Konsultimet për lëndët e Provimeve të Lirimit zhvillohen në bazë klase.
3. Grafiku i konsultimeve ka vlerë deri në përfundimin e shkollës; pastaj zëvendësohet me grafikun e ri të konsultimeve të ditëve përpara provimeve.

4. Në grafikun e parë, përpara përfundimit të shkollës, me secilën klasë të zhvillohen dy orë konsultim në jave, një në letërsi dhe një në matematikë.
5. Në grafikun e dytë, përpara ditëve të provimit, me secilën klasë të zhvillohen 5 orë konsultime për gjuhën dhe 8 orë konsultime për matematikën.
6. Orët e konsultimeve të llogariten në ngarkesën vjetore të mësuesit.
7. DAR/ZA të monitorojnë punën e drejtorive të shkollave për zhvillimin e konsultimeve në shërbim të nxënësve të klasës së IX në arsimin bazë.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Zëvendësministri që mbulon arsimin parauniversitar, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	Jovan KRISTIQI	_____	___.02.2010
Drejtori i DEP	Fatmir VEJSIU	_____	___.02.2010
Sekretari i Përgjithshëm	Skënder UKU	_____	___.02.2010